

## UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

### Matura Shtetërore 2019

1. **Formulari A1** plotësohet online.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maurantët/maurantet e vitit shkollor 2018 - 2019.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar e-albania, dhe përfundon në shkollë në portalin e Maturës.
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** në shkollë ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet "mbikëqyrës".
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi vendos kodin mbikëqyrësit në sistem, mauranti/maurantja mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1** në shkollë.
6. Formulari i plotësuar printohet, nënshkruhet nga mauranti/maurantja dhe mbikëqyrësi si dhe vulloset nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Shkolla ruan një kopje të formularëve të printuar deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2019.

### I. TË DHËNA PERSONALE

**Plotësohen nga mauranti/maurantja.**

- **Tek pika 1 e formularit A1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), mauranti/maurantja shënon numrin e tij/saj personal që ka në dokumentin e identifikimit. Ky informacion është i detyrueshëm dhe pa plotësuar atë, nuk mund të vijohet me aplikimin.

Për të dhënat në pikat **2-5 të formularit A1**, pasi mauranti/maurantja bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6 e formularit A1**, mauranti/maurantja shënon në fushat përkatëse adresën e email-it dhe numrin e telefonit të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2019, me qëllim që ai/ajo (mauranti/maurantja) të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit. Nëse mauranti/maurantja nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikëqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7 e formularit A1**, shënohet X tek kutizat pranë Po ose Jo.

## II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, maturanti/maturantja dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për secilën nga rubrikat përkatëse:

### Plotësohen nga maturanti/maturantja.

- **Tek pika 8 e formularit A1:** (emri i qytetit/fshatit), maturanti/maturantja shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po ndjek studimet.
- **Tek pika 9 e formularit A1:** (emri i shkollës ku studion), maturanti/maturantja shënon emrin e shkollës ku po studion.

### Plotësohen nga mbikqyrësi.

- **Tek pika 10 e formularit A1,** mbikqyrësi plotëson emrin e DAR/ZA-së përkatëse.
- **Tek pika 11 e formularit A1,** (indeksi i profilit), mbikqyrësi zgjedh nga lista numrin dyshifror që i përket emërimit të profilit të shkollës ku ndjek studimet maturanti/maturantja, sipas listës së miratuar nga MASR.
- **Tek pika 12 e formularit A1,** (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.
- **Tek pika 13 e formularit A1,** mbikqyrësi plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studion maturanti/maturantja.
- **Tek pika 14 e formularit A1,** zgjidhet nga lista, gjuha e huaj që në planin mësimor të shkollës trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar.

## III. TË DHËNA LËNDORE

### Plotësohen nga maturanti/maturantja.

- **Tek pika 15 e formularit A1**
- Numri i lëndëve që do të zgjidhen do të jetë 1 (një). maturanti/maturantja zgjedh nga lista lëndëve me zgjedhje Z, lëndën që dëshiron të japë provim.
- Zgjedhja e lëndës bëhet në përputhje me Udhëzimin Nr. 3, datë 14.02.2018, "Për organizmin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të MSH 2019", i ndryshuar dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të MSH Profesionale 2019".
- Teoria profesionale është e zbrërthyer në profile sipas indeksit të shkollave.
- Maturanti/maturantja e shkollave profesionale zgjedhjen e lëndës me zgjedhje (që për ta do të konsiderohet provim i detyruar) duhet ta bëjë detyrimisht grupin III, "Për shkollat e mesme profesionale".

## DHE SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE

[illegible]

| Nr   | Lënda                                                                         |
|------|-------------------------------------------------------------------------------|
| III. | <b>Për shkollat e mesme profesionale<br/>“Teori profesionale e integruar”</b> |
| 1    | Hoteleri-turizëm                                                              |
| 2    | Shërbime mjetesh transporti                                                   |
| 3    | Mekanikë                                                                      |
| 4    | Elektroteknikë                                                                |
| 5    | Elektronikë                                                                   |
| 6    | Përpunim druri                                                                |
| 7    | Ndërtim                                                                       |
| 8    | Tekstil-konfeksione                                                           |
| 9    | Tekstil-konfeksione (NABER ADA)                                               |
| 10   | Teknologji ushqimore                                                          |
| 11   | Bujqësi                                                                       |
| 12   | Shërbime sociale dhe shëndetësore                                             |
| 13   | Instalues i sistemeve termohidraulike                                         |
| 14   | Teknologji kimike                                                             |
| 15   | Peshkim                                                                       |
| 16   | Detari                                                                        |
| 17   | Gjeologji-miniera                                                             |
| 18   | Llogari                                                                       |
| 19   | Shërbime bankare                                                              |
| 20   | Sipërmarrje e agjencisë turistike                                             |
| 21   | Sigurime                                                                      |
| 22   | Tregti                                                                        |
| 23   | Administrim biznesi                                                           |
| 24   | Rrjete të dhënash                                                             |
| 25   | Mbështetje e përdoruesve të TIK                                               |
| 26   | Zhvillim website                                                              |
| 27   | Rrjete të dhënash (pilot-giz)                                                 |
| 28   | Inxhinieri informatike softwaresh (Hermann Gmeiner)                           |
| 29   | Silvikulturë                                                                  |
| 30   | Agrobiznes                                                                    |
| 31   | Veterinari                                                                    |
| 32   | Gjeodezi                                                                      |
| 33   | Biznes (Harry Fultz)                                                          |
| 34   | Elektronikë (Harry Fultz)                                                     |
| 35   | Automekanik (Harry Fultz)                                                     |

| Indeksi i<br>profilit/degës | Emërtimi i profilit/degës                  |
|-----------------------------|--------------------------------------------|
| 01                          | GJIMNAZ                                    |
| 02                          | GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR               |
| 03                          | SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-FRENGJISHT        |
| 04                          | SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-ITALISHT          |
| 05                          | SEKSIONI DYGJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT       |
| 06                          | GJIMNAZ GJUHËSOR                           |
| 07                          | SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE             |
| 08                          | SHKOLLË SPORTIVE                           |
| 09                          | SHKOLLË PEDAGOGJIKE                        |
| 10                          | HOTELERI-TURIZËM                           |
| 11                          | SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI                |
| 12                          | MEKANIKË                                   |
| 13                          | ELEKTROTEKNIKË                             |
| 14                          | ELEKTRONIKË                                |
| 15                          | PËRPUNIM DRURI                             |
| 16                          | NDËRTIM                                    |
| 17                          | TEKSTIL-KONFEKSIONE                        |
| 18                          | TEKNOLOGJI USHQIMORE                       |
| 19                          | BUJQËSI                                    |
| 20                          | SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETSORE           |
| 21                          | VETERINARI                                 |
| 22                          | GJEODEZI                                   |
| 23                          | INSTALUES I SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE      |
| 24                          | LLOGARI                                    |
| 25                          | SHËRBIME BANKARE                           |
| 26                          | ADMINISTRIM BIZNESI                        |
| 27                          | RRJETE TË DHËNASH                          |
| 28                          | MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK            |
| 29                          | TEKNOLOGJI KIMIKE                          |
| 30                          | SIPËRMARRJE E AGJENCISË TURISTIKE          |
| 31                          | AGROBIZNES                                 |
| 32                          | ZHVILLIM WEBSITE                           |
| 33                          | SIGURIME                                   |
| 34                          | SILVIKULTURË                               |
| 35                          | HARRY FULTZ, BIZNES                        |
| 36                          | HARRY FULTZ, ELËKTRONIKË                   |
| 37                          | HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK                   |
| 38                          | PETER MAHRINGER, TEKNOLOGJI INFORMACIONI   |
| 39                          | PESHKIM                                    |
| 40                          | GJEOLOGJI-MINIERA                          |
| 41                          | TREGTI                                     |
| 42                          | RRJETE TË DHËNASH (PILOT-GIZ)              |
| 43                          | INXHINIERI INFORMATIKE SOFTWARESH (HERMANN |
| 44                          | TEKSTIL-KONFEKSIONE(NABER ADA)             |
| 45                          | DETARI                                     |
| 46                          | PROFILI IM S'ËSHTË NË LISTË                |